




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 2022/1 prot.

Tiranë, më 02.08. 2024

Lënda: Kërkesë për publikim të vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Bashkia Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Blv. "Bajram Curri"
Tiranë

Në zbatim të VKM me nr.243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, kreu II, pika 6 dhe Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 19, pika 1 dhe 2. Ju dërgojmë kërkesën për publikimin e vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni shpalljet për:

- 1 (një) vend i lire pune **Specialist I / IT, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve**
2. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve**
3. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I, Sektori i tregjeve, Drejtoria e Pastrimit të Qytetit.**
4. 2 (dy) vende të lira pune **Specialist I, Sektori Teknik, Drejtoria e Zonave Rurale dhe Unazës së Madhe.**
5. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I, Sektori i Zonave Rurale, Drejtoria e Zonave Rurale dhe Unazës së Madhe.**
6. 2 (dy) vende të lira pune **Specialist I, Sektori i Unazës së Madhe, Drejtoria e Zonave Rurale dhe Unazës së Madhe.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Liri Qoshi



B40

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

SHPALLJE PËR VËNDE TË LIRA PUNE

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)”; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Vendimit Nr. 30628/3 prot, datë 01.09.2022 nga Kryetari i Bashkisë Tiranë “Për Miratimin e Rregullores Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë; Urdhrit Nr.32227/1 prot, datë 30.08.2024 për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë:

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit shpall procedurat për vendet e lira të punës:

1. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I / IT, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve**
2. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve**
3. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I, Sektori i tregjeve, Drejtoria e Pastrimit të Qytetit.**
4. 2 (dy) vende të lira pune **Specialist I, Sektori Teknik, Drejtoria e Zonave Rurale dhe Unazës së Madhe.**
5. 1 (një) vend i lire pune **Specialist I, Sektori i Zonave Rurale, Drejtoria e Zonave Rurale dhe Unazës së Madhe.**
6. 2 (dy) vende të lira pune **Specialist I, Sektori i Unazës së Madhe, Drejtoria e Zonave Rurale dhe Unazës së Madhe.**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si më poshtë:

- 1) Të jetë shtetas shqiptar;
- 2) Të zotërojë diplomë të nivelit Master i Shkencave ose Master Profesional, diplomë e barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- 3) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;

4) Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim;
- 2) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 3) Fotokopje e diplomës dhe lista e notave;
- 4) Certifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në **Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit** me adresë: **Rruga "5 Maji", Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri**, ose dorazi pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, brenda datës **10.09.2024**.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për punën.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit do të shpallë fituesit, si dhe do të njoftojë kandidatët jo fitues, të cilët kanë të drejtë të ankimohen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në DPPGJ. Pas përfundimit të konkursit, kandidatët jo fitues mund të paraqiten brenda 7 ditëve për tërheqjen e dokumentacionit.